



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
MINISTRI



Nr. 5148 Prot.

Tiranë, më 14.09. 2012

UDHËZIM

NR. 23 DATË 14.09. 2012

PËR

PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË  
TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT  
TË LARTË SI EDHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE  
PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës pika 4, të nenit 33 dhe 35 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit nr. 420, datë 27.06.2012, të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si edhe tarifën e shkollimit për vitin akademik 2012 - 2013", të Vendimit nr. 78, datë 08.02.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimit në shkollat e larta publike", i ndryshuar, të Vendimit nr. 1013, datë 10. 12. 2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)",

UDHËZOJ :

1. Pranimi i kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë (IAL), në vitin akademik 2012-2013, të bëhet sipas listave emërore të renditura nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP).
2. Kandidatët fitues të përcaktohen nga AKP në bazë të parimeve të Meritës dhe Preferencës:
  - a. Parimi i Meritës përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar (për programe të caktuara studimi) në bazë të Udhëzimit nr. 12, datë 11.07.2012, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2012-2013".
  - b. Parimi i Preferencës përcaktohet nga vullneti i kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të grupit të preferencave fituese, ndër jo më shumë se 10 preferenca të përzgjedhura nga ata vetë në formularin A2.

3. AKP brenda datës **18 Shtator 2012** të dërgojë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat e kandidatëve fitues (faza e parë), të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe të preferencës më të lartë fituese të kërkuar prej tyre në Formularin A2, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me Vendimin nr. 420, datë 27.06.2012, të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimi në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe tarifatat e shkollimit, për vitin akademik 2012-2013".
4. Listat e kandidatëve fitues (faza e parë), shpallen në faqet elektronike zyrtare të MASH dhe AKP-së. AKP i dërgon Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe DAR/ZA-ve, listat e kandidatëve fitues në formë shkresore dhe elektronike, brenda datës **18 Shtator 2012**. Këto institucione, duke filluar nga kjo datë, t'i publikojnë listat në vende të dukshme në mjediset e fakulteteve përkatëse dhe shkollave të mesme të varësisë.
5. AKP dhe sekretaritë mësimore të fakulteteve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të ngarkohen për organizimin dhe realizimin e procesit të pranimi dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë.
6. Kandidati i shpallur fitues në listën paraprake regjistrohet on-line, në programin e studimit që ka fituar, në Portalin e Maturës Shtetërore, sipas procedurës së mëposhtme:
  - 6.1 a) Regjistrimi on-line kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në Shtojcën nr 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi), nga data **18 Shtator 2012** deri në orën 24:00 të datës **23 Shtator 2012**.
    - b) Kandidati fitues ka të drejtë të qëndrojë përfundimisht i regjistruar në programin e fituar në fazën e parë (listat paraprake), duke përzgjedhur opsionin "**Konfirmoj regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar**" (shih shtojcën nr. 1).
  - 6.2 a) Kur kandidati **nuk arrin të realizojë regjistrimin on-line**, ai duhet të paraqitet pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është shpallur fitues, nga data **18 Shtator 2012** deri në datë **23 Shtator 2012**, nga ora 08:00, deri në orën 18:00. Sekretaria mësimore kryen regjistrimin on-line të kandidatit. Në këtë rast, kandidati duhet të paraqesë një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosjen e sekretarisë mësimore mbahet fotokopja e dokumentit të identifikimit. Regjistrimi on-line i studentit nga sekretaria mësimore e fakultetit, kryhet sipas procedurave të parashikuara në Shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
    - b) Gjatë kryerjes së procedurës së regjistrimit on-line, sekretaritë mësimore të fakulteteve duhet të mbajnë detyrimisht një regjistër të veçantë, në të cilin kandidatët fitues dhe sekretarja nënshkruajnë në momentin e regjistrimit, duke shënuar datën dhe orën e regjistrimit.
    - c) Sekretaria mësimore pajis kandidatin me fletë-regjistrimi ku shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data dhe ora e regjistrimit. Fletë-regjistrimi i vulosur duhet të jetë i nënshkruar nga dekanı dhe kryesekretarja mësimore e fakultetit.
    - ç) Studentët, të cilët duan të mbeten në preferencën e fituar në fazën e parë, nënshkruajnë një deklaratë në sekretarinë mësimore sipas modelit të Shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Sekretaria mësimore pajis menjëherë kandidatët me fletë-regjistrimin në preferencën e përzgjedhur.
    - d) IAL-të Publike, deri në orën 14:00, të datës **25 Shtator 2012**, të dorëzojnë në AKP: listën origjinale të fituesve të regjistruar pranë sekretarive mësimore, në formë shkresore dhe elektronike sipas formatit të përgatitur nga AKP, si edhe kopje të deklaratat origjinale të studentëve sipas pikës 6.2/c të këtij udhëzimi.

- 6.3 Kandidati që dëshiron të vazhdojë garën për të fituar preferenca më të larta, gjatë regjistrimit on-line të kryer personalisht ose pranë sekretarisë mësimore, ndjek procedurën e parashikuar në shtojcën nr. 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.
7. Kandidati, i cili nuk kryen regjistrimin brenda datave të përcaktuara në këtë udhëzim, për çfarëdo lloj arsye, humbet të drejtën e regjistrimit dhe të vazhdimit të procesit. Ky kandidat nuk përfshihet në listën përfundimtare të fituesve.
8. AKP shpall, në datën **1 Tetor 2012**, listën përfundimtare të kandidatëve fitues. Lista shpallet edhe në faqet zyrtare elektronike të MASH dhe AKP-së. Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe DAR/ZA-të të shpallin në vende të dukshme listat përfundimtare brenda datës **2 Tetor 2012**.
9. Sekretaritetë mësimore të fakulteteve nga datat **08 - 13 Tetor 2012**, gjatë orarit 08:00, deri në orën 18:00, të pranojnë dokumentacionin plotësues për të gjithë kandidatët fitues. Kandidatët dorëzojnë personalisht dokumentacionin plotësues të mëposhtëm:
- Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumentave;
  - 2 fotografi;
  - Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1.600 lekë, paguar pranë zyrave të Postës Shqiptare, për llogari të IAL-së Publike përkatëse.
- Gjatë kryerjes së procedurës së dorëzimit të dokumentacionit plotësues, sekretaritetë mësimore të fakulteteve mbajnë regjistër të veçantë me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve fitues dhe sekretarisë mësimore.
10. Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të dorëzojnë pranë AKP-së, deri në datën **14 Tetor 2012**, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar, për çdo program studimi, të ciklit të parë me kohë të plotë, sipas Udhëzimit Nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar, në formë shkresore dhe elektronike.
11. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit Nr. 9, datë 25.02.2010 "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore".
12. Pranimi i kandidatëve që kërkojnë të transferojnë studimet në institucionet publike të arsimit të lartë të kryhet sipas kritereve të përcaktuara në statutet e institucioneve dhe rregulloren e njësisë kryesore ku bëhet transferimi i studimeve. IAL-të të pranojnë kërkesat për transferim deri në datë **24 shtator 2012** dhe të dërgojnë në MASH propozimet e tyre për kuotat e transferimeve, sipas programeve përkatëse të studimit, brenda datës **26 Shtator 2012**.
13. Pranimi i kandidatëve për një program të dytë studimi do të kryhet nga institucionet publike të arsimit të lartë sipas kritereve të përcaktuara në statutet e institucioneve dhe rregulloren e njësisë kryesore ku bëhet regjistrimi për një program të dytë studimi. IAL-të të pranojnë kërkesat për program të dytë studimi deri në datë **24 shtator 2012** dhe të dërgojnë në MASH propozimet e tyre për kuotat për program të dytë studimi, sipas programeve përkatëse të studimit, brenda datës **26 Shtator 2012**.
14. Rektoratet dhe dekanatet të shpallin në mënyrë të qartë dhe në vende të dukshme, në mjediset e fakulteteve përkatëse: datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit on-line nga sekretaritetë mësimore, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve plotësues si dhe njoftime të tjera të nevojshme. Këto njoftime të publikohen edhe në median e shkruar dhe elektronike nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë.

15. Udhëzimi Nr.14, datë 20.07.2012 “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë dhe Institucionet publike të Arsimit të Lartë si dhe transferimin e studimeve” shfuqizohet.
16. Ngarkohen Zëvendësministri për Arsimin e Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor si dhe Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

**MYQEREM TAFAJ**  
  
**MINISTËR**

